

KONTRATE SHITJE AKSIONESH

Në Tiranë, sot me datë 25 Mars 2022 në selinë e shoqërisë M-INVEST SH.A me adresë në Durres Maminas,VLASHAJ Autostrada Tirane-Durres, Km.19, Zona Kadastrale 3796, Godina Deutschcolor sha, palët si më poshtë hartuan këtë kontratë shitje:

SHITESI :

Z.Luan Muça, shtetas shqiptar, lindur në Elbasan dhe banues në Tiranë, i dtl. 05.08.1971, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal H10805062A.

BLERESI :

Zj.Mia Muça, shtetase shqiptare, lindur në Elbasan dhe banuese në Tiranë, e dtl. 06.07.1974, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal H457061290;

Palët e mësipërme kryen redaktimin e kësaj kontrate shitje aksionesh në vazhdim:

Shitësi Luan Muça, është zotërues i 1(një) aksioni që përfaqëson 100 % të kapitalit të shoqërisë M-INVEST SH.A, e cila është një shoqëri tregtare shqiptare e themeluar më datë 26.04.2018 dhe e regjistruar pranë QKB-së, me datë 02/05/2018, me NIPT L817025030.

Kapitali i shoqërisë është në shumën 3,500,000 lekë, i zotëruar nga aksioneri i vetëm, si më poshtë:
Z.Luan Muça 1 (një) aksioni 100 % për shumën 3,500,000 lekë.

Objekti i kontratës

Asambleja e aksionarit të vetëm të shoqërisë me vendimin e datës 25.03.2022, bazuar në Ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Statutin e Shoqërisë, etj., ka vendosur:

Shitjen e 100% të kapitalit të zotëruar në shoqëri nga aksionari Luan Muça, bleresit Mia Muça.

Me këtë kontratë shitje bëhen ndryshimet si më poshtë:

- Luan Muça, **ishte**, aksionar i vetëm i shoqërisë dhe zotërues i 1(një) aksioni, që përfaqëson 100% të kapitalit me vlerë 3.500.000 lekë;
- Zj.Mia Muça Z, **behët**, aksionar i vetme e shoqërisë dhe zotërues i 1(një) aksioni, që përfaqëson 100% të kapitalit me vlerë 3,500,000 lekë.

Çmimi i shitjes

Çmimi i shitjes së aksionit, që përfaqëson 100 % të kapitalit të zotëruar nga aksionari Luan Muça, që transferohet nëpërmjet kesaj kontrate shitje në favor të bleresit Mia Muça është 3,500,000 lekë ose kundërvlera në lekë në datën e kryerjes së transaksionit, në marrëveshje midis palëve dhe pasi të jetë verifikuar gjendja pasurore e shoqërisë dhe derdhja e kapitalit të regjistruar.

Blerësi në marrëveshje me shitësin, deklaron se dokumentimi i likuidimit të vlerës së plotë, bëhet vetëm nëpërmjet llogarisë bankare dhe palët nuk kanë asnjë pretendim tjetër.

Kalimi i pronesisë së aksioneve bëhet menjëherë me rënshkrimin e kësaj kontrate nga shitësi në favor të bleresit.

Garancitë

Shitësi deklaron dhe garanton se është i vetmi titullar i ligjshëm i aksioneve që po transferohet nëpërmjet kesaj kontrate dhe se ajo është e lirë nga çdo barrë apo pretendim tjetër ligjor.

Heqje dorë nga të drejtat dhe detyrimet

Shitësi deklaron nën përgjegjësinë e tij personale se heq dorë nga të gjitha të drejtat që i takojnë mbi aksionin që po e transferon nëpërmjet kësaj kontrate shitje në favor të Bleresit Mia Muça, e cila bëhet pronare e ligjshëm e këtij aksioni.

Kjo kontratë u hartua në 3 kopje me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe dhe palët pasi e lexuan, e kuptuan, deklaruan se janë dakort me sa më sipër, dhe e nënshkruan rregullisht.

SHITËSI

Luan Muça



BLERËSI

Mia Muça

